



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

RAPORTI GJYSMËVJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023

1. **Përmbledhja ekzekutive** (*pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë*)

Ministria e Brendshme ka kryer procesin e konsultimit publik për 8 projektakte, për të cilat ka përmbushur 100% detyrimin që buron nga plani vjetor dhe gjithë procesi i konsultimit publik dhe rezulton se 6 projektakte janë miratuar dhe kanë qenë objekt i konsultimit publik.

Referuar pikëzimit të cilësisë sipas metodologjisë SIGMA, e cila shërben për vlerësimin e performancës institucionale në procesin e konsultimit publik, cilësia e konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme rezulton maksimale. Kjo sepse për të gjitha aktet e konsultuara të publikuara në sistemin e informacionit qeveritar (RENJK), është hartuar raporti individual i secilit projektakt, mbi përfshirjen e palëve të interesit dhe janë mbledhur prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, një pjesë e mirë e të cilëve janë bërë pjesë e aktit final e të miratuar dhe normalisht ky raport është publikuar në RENJK.

Raporti final për projektaktin e konsultuar dhe miratuar është përgatitur me kujdesin maksimal, nga strukturat teknike në bashkëpunim me koordinatorin e konsultimit publik për institucionin, duke vlerësuar dhe synuar përfshirjen në mënyrë shteruese të kontributit, përmes komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit, qytetarëve, të aktorëve të jashtëm jo-qeveritarë, anëtarëve të organeve këshillimore, rrjedhimisht ka qenë sfidë reflektimi i komenteve në rast të numrit shumë të lartë të tyre.

Gjithashtu, publikimi i raportit final në RENJK, përpara miratimit të aktit në Këshillin e Ministrave, ka si qëllim rritjen e transparencës, nxitjen e publikut për të dhënë mendime, sugjerime e rekomandimeve në mënyrë të vazhdueshme mbi çdo projektakt apo edhe krijimin e mundësisë efektive dhe efikase për të parë rezultatin e punës së tyre dhe për të reaguar sërish në rast mendimi ndryshe.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se ka pasur një numër total prej 3674 vizitorësh për projektaktet e konsultuara në këtë platformë apo të miratuara për periudhën janar-qershor 2023. Ndërkohë, konsultimi publik

është realizuar edhe nëpërmjet tryezave të konsultimit publik, ku ka pasur përfaqësi nga disa grupe interesi të cilët kanë dhënë kontributin e tyre.

Përzgjedhja e projektakteve për konsultim është parashikuar në përputhje ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore.

Në zbatim të urdhrit nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”, konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun.

Ndërsa në nenin 4, të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj. Rrjedhimisht, aktet e Ministrisë së Brendshme të cilat janë të kësaj natyre, janë përjashtuar nga ky proces, duke i evidentuar në planin vjetor, sipas përjashtimit përkatës.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. *Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike*

Janë kryer konsultime publike për 8 projektakte, si vijon:

1. Projektvendimi “Për miratimin e planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025, të ndryshuar” (titulli është ndryshuar si vijon “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022”, të ndryshuar”);
2. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”;
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, “Për armët””, i ndryshuar;
4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin””;
5. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave””;

6. Projektvendim "Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit 2021-2023""";
7. Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligj nr. 113/2020, "Për Shtetësinë"";
8. Projektudhëzim "Për kushtet teknike të importit, tregtimit, të mirëmbajtjes, së testimi të shërbimit të aparateve të fikseve të zjarrit";

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në gjashtë mujorin e parë?

Numri total i akteve të miratuara në këtë 6 gjashtë (mujor) është 22 projektakte, nga të cilat 17 vendime të Këshillit të Ministrave dhe 5 udhëzime të ministrit.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Numri total i akteve të miratuara këtë 6 mujor, të cilat janë objekt konsultimi dhe për të cilat është kryer procesi i konsultimit janë 6 projektakte.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave, tre projektligje i janë procesit të vlerësimit të ndikimit, shoqëruar me raportet përkatëse të vlerësimit të ndikimit (VNR), të cilat janë miratuar dhe konsultuar gjatë kësaj periudhe.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga 31 projektakte, të cilat janë në përputhje me PKIE, PA dhe Dokumentet Strategjike, për 19 projektakte janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike.

Më konkretisht, të gjitha aktet, pra 19 akte janë përjashtuar për kriterin "aktet administrative individuale dhe aktet administrative normative".

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e akteve që iu nënshtruan konsultimit publik dhe u miratuan këtë 6 mujor përkojnë me 3 projektligje dhe 3 projektvendime të Këshillit të Ministrave.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me një vit më parë, konkretisht me konsultimin në vitin 2022, lidhur me kriteret apo përjashtimet nga konsultimet publike rezulton se numri i akteve të përjashtuara nga ky proces është më i vogël. Pasi në vitin 2022, 21 akte kanë qenë të përjashtuara si akte administrative individuale apo me karakter normativ, ndërkohë që për këtë vit numërohen 19 akte të tilla, duke mos përfshirë kriteret apo përjashtime të tjera.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 6 (gjashtë):

1. Konsultim e këshillim gjatë hartimit të draftit të aktit nëpërmjet grupit të punës dhe ekspertizës së ekspertëve të ndryshëm ndërkombëtarë sipas fushës përkatëse, apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtarë të cilat asistojnë institucionin (të gjitha konsultimet);
2. Tryeza/Takim konsultative, pas përgatitjes së draftit të aktit, me aktorët e targetuar si: shoqëri civile, shoqata, organizata kombëtare apo ndërkombëtare, Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore (për të gjitha aktet e vetëqeverisjes vendore);
3. Konsultimi në faqen zyrtare të Regjistrat Elektronik për Konsultimin dhe Njoftimin (RENJK) (8 konsultime);
4. Mekanizmi IPMG (1 projektakt);
5. Konferenca; (1 projektakt);
6. Posta elektronike (të gjitha konsultimet).

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Përveç komenteve të gjeneruara përmes sistemit e-akte nga ministritë e linjës, rezultoi se metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave/takimeve të konsultimit. Numri i komenteve përmes konsultimit në fazën paraprake të draftimit të aktit, përmes tryezave të konsultimit ka qenë i lartë referuar ekspertizës së ekspertëve të ndryshëm apo përfaqësuesve të ndryshëm me njohuri të thelluara mbi projektaktin. Sjellim në vëmendje se edhe numri i vizitorëve që konsultohen apo dërgojnë mendime përmes RENJK është përmirësuar. Gjithsesi, edhe metoda përmes emailit rezultoi të jetë shumë e përdorur nga organizatat e shoqërisë civile të cilët zgjedhin që komentet e tyre t'i dërgojnë në adresën e koordinatorit të konsultimit publik apo personit tjetër të kontaktit, sikurse specialist përkatës përgjegjës për hartimin e projektaktit.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Metoda e konsultimit praparak në fazat e hershme të hartimit është përdorur për 2 projektvendime që përkojnë me Strategjitë mbi decentralizimin dhe luftën kundër terrorizmit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për të gjitha aktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, është kryer publikimi në RENJK, duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditë pune, për aktet e konsultuara në RENJK.

Për projektaktet e mëposhtme, ka qenë periudha më e gjatë e konsultimit, pasi pati një zgjatje afati me qëllim respektimin e ligjit për kohëzgjatjen minimum 20 ditë pune, si vijojnë:

-Projektvendimi *"Për miratimin e planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër kimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025, të ndryshuar"* (titulli është ndryshuar si vijon *"Për disa ndryshime në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë kundër Kimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022", të ndryshuar"*);

-Projektvendimi *"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve"*.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë minimalisht rreth 30 ditë kalendarike, por ky afat për disa akte ka zgjatur edhe disa muaj, duke pasur në vëmendje kohën gjatë të cilës ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, zhvillimin e konsultimeve paraprake, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK apo zhvillimin e tryezave publike, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final shoqëruar me relacionin shpjegues për secilin projektakt.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim të konsiderueshëm të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike e takime, situatë e njëjtë me vitin e kaluar.

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e publikuara gjatë vitit 2022 dhe për aktet e publikuara në 2023 u realizua në përputhje me parashikimin ligjor, për respektimin e afatit e kohëzgjatjes prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit.

Gjithashtu, vihet re një përmirësim i situatës nga vitet e kaluara pasi rezulton se si në 2022 dhe në këtë vit janë përcjellë komente për projektaktet edhe përmes RENJK ose përmes emailit pasi projektakti është publikuar në RENJK. Situata edhe këtë vit është përmirësuar në kuadër të marrjes së kontributit dhe komenteve nga grupet e interesit, si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv dhe me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për këtë 6 mujor ka pasur një numër të madh të pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, konkretisht:

- Sa i takon projektvendimit të Strategjisë së Decentralizimit numri i aktorëve të jashtëm, jo qeveritar theksojmë se kontribuan 6 aktorë përkatësisht: Shoqata për Autonominë Vendore, IDM, IDRA, Aleanca Kombëtare e Këshilltareve, Ambasada Zviceriane, Ambasada Austriake.

- Sa i takon projektligjit për shtesat dhe ndryshimet të ligjit për Shtetësinë, numri i aktorëve të jashtëm joqeveritar përkon me një qytetar.

-Për projektligjin e Shërbimit Zjarrfikës kanë dhënë kontribut përmes komenteve 4 aktorë të jashtëm joqeveritar sikurse një qytetar, dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Zjarrfikës;

- Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, "Për armët”” dha kontribut një subjekt.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2023, ka pasur pjesëmarrje të anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës, të cilët kanë dhënë asistencën e tyre nëpërmjet takimeve të ndryshme konsultuese si:

- ekspertë individual, vendas apo të huaj;

- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;

- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë;

- përfaqësues nga ambasada të ndryshme;

-përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, anëtarë të shoqërisë civile, media.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Sa i takon projektvendimit të Strategjisë së Decentralizimit numri i aktorëve të jashtëm, jo qeveritar theksojmë se kontribuan 6 aktorë, përkatësisht:

1. Shoqata për Autonominë Vendore,

2. IDM,

3. IDRA,

4. Aleanca Kombëtare e Këshilltareve,

5. Ambasada Zviceriane,

6. Ambasada Austriake.

- Sa i takon projektligjit për Shtetësinë numri i aktorëve të jashtëm joqeveritar përkon me një qytetar;

-Për projektligjin e Shërbimit Zjarrfikës kanë dhënë kontribut përmes komenteve 4 aktorë të jashtëm joqeveritar sikurse një qytetar, dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Zjarrfikës.

Më poshtë, sjellim në vëmendje numrin e klikimeve në RENJK, për projektaktet e konsultuara, duke i konsideruar me rëndësi, të cilët kanë treguar interes për projektaktet, si vijojnë:

1. Projektligj *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligj nr. 113/2020, "Për Shtetësinë"*; - 583 shikime;
2. Projektudhëzim *"Për kushtet teknike të importit, tregtimit, të mirëmbajtjes, së testimit të shërbimit të aparateve të fikseve të zjarrit"*, - 282 shikime;
3. Projektligji *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, "Për armët"*, i ndryshuar; - 464 shikime;
4. Projektligji *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"*, - 649 shikime;
5. Projektvendimi *"Për miratimin e planit të veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021-2025, të ndryshuar"* (titulli është ndryshuar si vijon *"Për disa ndryshime në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022"*, të ndryshuar"), - 365 shikime;
6. Projektvendimi *"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve"*, - 525 shikime;
7. Projektligji *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004, "Për sistemin e adresave"*; - 562 shikime;
8. Projektvendim *"Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 1137, datë 16.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit 2021-2023"* – 806 shikime.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Sikurse u përmendën edhe më lart, struktura e kontribuesve krahas atyre institucionalë (anëtarë të grupeve të punës) dhe qytetarëve ishin edhe personat juridikë:

- Këshilli Konsultativ i Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme, Këshillat e Qarqeve, kryetarët e Bashkive dhe kryetarë të Këshillave Bashkiak.

- Organizatat përfaqësuese të shoqërisë civile e persona të tjerë juridikë, konkretisht: shoqatat e vetëqeverisjes vendore, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që operon në fushën e tregtimit dhe

mirëmbajtjes të pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri, MSSC, Sindikata e Punonjësve MZSH, IDM, IDRA, Aleanca Kombëtare e Këshilltareve, Ambasada Zviceriane, Ambasada Austriake, EU4LEA, GIZ.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar, gjë që konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Brendshme, rritja e angazhimit të organizatave jofitimprurëse në procesin e dhënies së kontributit për hartimin e këtyre akteve, të cilat për vitin 2023 kanë dërguar më së shumti me email mendimet e tyre, pas konsultimit të RENJK.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në lidhje me numrin e komenteve dhe rekomandimeve të marra gjithsej dhe mesataren, duke i'u referuar 6 projektakteve të miratuara objekt i konsultimit publik theksojmë se janë 93 komente dhe rekomandime në tërësi, përkatësisht:

1. Vendimi nr. 81, datë 14.2.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe të planeve të veprimit 2023-2025";- 0 komente
2. Vendimi nr. 252, datë 20.4.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve"; - 52 komente
3. Vendimi nr. 54, datë 1.2.2023 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2023 " Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025, dhe planin e veprimit 2023-2025". – 31 komente
4. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014, "Për shërbimin privat të sigurisë fizike";- 8 komente
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, "Për armët", të ndryshuar";- 1 koment
6. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.113/2020, "Për shtetësinë";- 1 koment

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Sa i takon komenteve të pranuar plotësisht numri i tyre është është 87, numri i komenteve të pranuar pjesërisht është 5 dhe numri i komenteve të refuzuara është 1.

Projektligji për shtetësinë, nga aktorët e jashtëm ka dhënë kontribut një qytetar komenti i të cilit është refuzuar. Ndërsa sa i takon projektligjit për armët ka dhënë kontribut një subjekt, komenti i të cilit është pranuar plotësisht. 49 komente të dërguara për strategjinë e decentralizimit janë pranuar plotësisht. 6 komente të pranuar plotësisht janë edhe për projektligjin e Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike. Edhe 31 komentet e projektvendimit "*Për një shtesë dhe një ndryshim në VKM nr. 1137, datë 16.10.2020 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021-2025 dhe të Planit të Veprimit 2021-2023"*", që është miratuar në 2023 janë pranuar tërësisht.

Në vijim rendisim konkretisht projektaktet e miratuara, të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit, si më poshtë:

1. Vendimi nr. 81, datë 14.2.2023 i Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe të planeve të veprimit 2023-2025*";
2. Vendimi nr. 252, datë 20.4.2023 i Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve*";
3. Vendimi nr. 54, datë 1.2.2023 i Këshillit të Ministrave "*Për disa ndryshime në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2023 " Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025, dhe planin e veprimit 2023-2025"*.
4. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014, "Për shërbimin privat të sigurisë fizike"*";
5. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, "Për armët", të ndryshuar"*";
6. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.113/2020, "Për shtetësinë"*".

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme dhe sa vjen e përmirësohet, pasi pothuajse 99% e komenteve të marra, janë reflektuar.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik, pasi ndryshimet nuk preknin përmbajtjen e VNR, por sigurisht këto ndryshime u reflektuan në draftin e projektligjit të dërguar për bashkërendim pranë ministrive të linjës.

2.6 **Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

2.6.1 *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Për të gjitha aktet e publikuara në RENJK, për të cilat afati i konsultimit është mbyllur dhe është bërë vlerësimi i komenteve nga strukturat teknike, institucioni publikoi 6 raporte konsultimi për rezultatet e këtij procesi, pavarësisht nëse janë marrë komente apo jo.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Të gjitha raportet finale pas reflektimit të komenteve në tabelën përkatëse të raportit janë publikuar.

2.7 **Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Referuar formatit të kërkuar nga njësia përkatëse në Kryeministri, e cila është hartuar nga MB argumentojmë si vijon: Indeksi Performancës për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme është 8 për secilin nga projektaktet e publikuara (Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara). Kurse në përqindje indeksi sasior është 100%, pasi për të gjitha aktet e konsultuara ka dëshmi të mjaftueshme mbi përfshirjen e palëve të interesit ku janë mbledhur prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, një pjesë e mirë e të cilave janë reflektuar dhe në projektakte.

3 **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik vazhdojnë të lidhen edhe këtë vit më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces. Gjithsesi theksojmë se situata e ndërgjegjësimit sa vjen e përmirësohet, referuar edhe numrit të shikimeve të projektakteve në RENJK, duke kuptuar rëndësinë e komentimit përmes këtij regjistri, pasi është drejtpërdrejt i monitoruar nga Kryeministria duke shtuar kontrollin në reflektimin e komenteve të përcjella përmes RENJK.

Gjithashtu, krahas publikut duhet të ketë një angazhim më të madh të strukturave teknike hartuese të akteve, pasi krahas bashkëpunimit dhe dhënies së kontributit për identifikimin e grupeve të interesit të përfshira, nevojitet informimi përmes zhvillimit të trajnimeve, mbi rëndësinë e procesit të konsultimit publik të projektakteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm gjatë procesit të konsultimit, edhe me qëllim rritjen e cilësisë së performancës në këtë proces.

Si përfundim, me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit, synohet sërish ndërgjegjësimi edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacionit.